



SHKOLLË KOMUNITARE  
SHKOLLË KOMUNITARE




**SHKOLLA**  
SI QENDËR KOMUNITARE

**Projekti:**  
**“Shkolla Komunitare”-Ekosistemi i Edukimit për  
Zhvillim të Qëndrueshëm**

**Relacion mbi Situatën e Përgjithshme në Shkollën “A. Z.  
Çajupi”, Tiranë**

**Dhjetor, 2015**



### Informacion i përgjithshem mbi Tiranën

E gjallë dhe me ngjyra, Tirana është rrahja e zendrës së Shqipërisë, ku shpresat dhe ëndrrat, në këtë vend të vogël rriten së bashku me konsumizmin e stuhishëm dhe argëtimin e shpenguar. Duke pësuar një transformim me përmasa të jashtëzakonshme, që kur u zgjua nga gjumi i saj komunist në fillim të viteve 1990, Qendra e Tiranës është tani e panjohshme, me ndërtesat e saj të pikturuar me ngjyra primare, sheshet publike dhe rrugët pedonale, një kënaqësi për sytë dhe turistat që enden në ato.

Tirana është kryeqendra e qarkut dhe e rrethit me të njëtin emër, si dhe kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë. Tirana ndodhet në qendër të Shqipërisë, rreth 35 km në lindje të Durrësit dhe rreth 40 km në veri-perëndim të Elbasanit, e rrethuar nga Mali i Dajtit në lindje, kodrat e Kërrabës dhe Saukut në jug, kodrat e Vaqarrit dhe Yzberishtit në perëndim

dhe ato të Kamzës në veri. Qyteti u themelua në vitin 1614 nga Sulejman Pashë Bargjini, me origjinë nga fshati Mullet. Për herë të parë emri i Tiranës përmendet në vitin 1418 në një dokument të Vendikut. Tirana u shpall kryeqytet i Shqipërisë në vitin 1925 nga Asambleja Kushtetuese. Sot qyteti po përjeton një periudhë të zhvillimit progresiv ekonomik, social dhe urban, me ndërtimin dhe rregullimin monumentale e parqeve, ndërtesave, duke përfshirë edhe rindërtimin e objekteve fetare të shkatërruara gjatë pushtimit turk dhe regjimit komunist.

Qyteti i Tiranës është qyteti më i madh i Shqipërisë dhe qendra më e madhe ekonomike, administrative, politike, industriale, mediatike, akademike, sociale dhe kulturore e vendit. Tirana ndodhet vetëm 17 km larg aeroportit “Nënë Tereza”, i vetmi aeroport ndërkombëtar në Shqipëri.

Univeriteti i Tiranës u themelua në vitin 1957 dhe kishte në përbërje të tij 6 fakultete. Në vitin 1991 nga ky universitet, asakohe me 11 fakultete, u shkëputën fakultetet inxhinierike, që krijuan Universitetin Politeknik Të Tiranës.



### **1. Informacion i pergjithshem mbi shkollën**

Gjimnazi “A. Z. Çajupi” është hapur në vitin 1959, në truallin ku ka qenë punishtja e familjes Qyqja. Në fillim kishte 62 mësues dhe 1348 nxënës. Gjimnazi “A. Z.Çajupi” ka qenë shkollë sportive me profil Atletik. Në vitin 1966, shkolla 8-vjeçare u nda nga shkolla e mesme. Rikonstruksioni i parë u bë në vitin 1999, në këtë vit stafi kishte 56 mësues dhe 1146 nxënës. Deri në vitin 2009 shkolla ka qënë me sistemin 4-vjeçar të studimeve, pas këtij

viti, duke iu përshtatur reformës që iu bë në sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri, kaloi në sistemin 3-vjeçar të studimeve.

Drejtori i parë ka qenë Z. Sofokli Afezulli, figura të shquara që kanë studiuar në këtë gjimnaz: Z. Rexhep Mejdani (ish president i Republikës), Z. Maqo Laknori (ish ministër i Arsimit).

## 2. Struktura Organizative e Shkollës

Gjimnazi “A. Z. Çajupi” është i pozicionuar në afërsi të qendrës së Tiranës dhe bën pjesë në njësinë bashkiake Nr. 3, me 43.270 banorë. Ndërtesa e shkollës përfaqësohet nga një godinë tre katëshe. Gjimnazi ka 34 mjedise që shërbejnë për zhvillim e orëve mësimore me një sipërfaqe prej 748 m<sup>2</sup>, bibliotekën e shkollës, 2 laboratorë informatike, terrene sportive me një sip. Prej 1500 m<sup>2</sup>, 1 sallë aktivitetesh, 1 dhomë e qeverisë së nxënësve, 1 sallë mësuesish, 1 dhomë mjeku, 1 dhomë dentisti, 1 dhomë psikologu, 2 zyra nëndrejtorësh, 1 zyrë drejtori, 1 sekretari. Mësimi fillon në orën 08:00 – 14:00. Ora e mësimi zgjat 45 minuta, ndërmjet orëve ka 5 minuta pushim dhe pas orës së tretë një pushim prej 25 minutash.

## 3. Objektivat e për tu realizuar në shkollën “A.Z.Çajupi”, Tiranë

Komponenti që do të konsolidohet në shkollën “A.Z.Çajupi” është ‘Rekreacion dhe Sport’. i cili ka në fokus hartimin, organizimin dhe realizimin e një sërë veprimtarish që kanë si qëllim aktivizimin e nxënësve dhe të rinjve në klube të ndryshme tematike (sport, letërsi, art, kreativitet, sipërmarrje, ICT, etj) si dhe testimin e aftësive dhe talenteve me anë të organizimit të aktiviteteve dhe konkurseve ndërmjet shkollave në nivel lokal dhe rajonal. Me anë të këtyre aktiviteteve synohet zhvillimi i aftësive inovative të shumëkërkua nga tregu i punës dhe shoqëria moderne, si dhe të rekomanduara si strategjike në dokumentat e ndryshëm të BE-së. Si hap i parë në Shkollën e mesme publike “A.Z.Çajupi” në Tiranë u bë një fotografim i gjendjes aktuale të ambienteve, të mësuesve dhe të specifikave që prezantonte ky gjimnaz. Nga ky fotografim rezultoi se ndër vite ishin zhvilluar një numër i konsiderueshëm aktivitetesh, si dhe pjesëmarrje në projekte dhe konkurse kombëtare e ndërkombëtare, ku nxënësit ishin nderuar dhe me çmime. Ndaj në këto kushte me këtë shkollë do të punohet për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe krijuese siç janë “Rrethi i letërsisë”, “Rrethi i ekologjisë dhe riciklimit” si dhe ekipi i futbollit dhe voleybollit për meshkuj dhe femra. Për të plotësuar më së miri komponentin e **rekreacionit dhe sportit**, do të mbështeten ekipet e sipërpërmendura dhe do të shihet asistimi dhe mbështetja në aktivitete si: Java e BE-se, Konkurse Debatit, revista e shkollës ose vendosja në dispozicion të nxënësve të disa faqeve në revistën tonë “Zera Studentorë, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta midis Klubit të Vullnetarëve të UMB – së dhe Rrethit të ekologjisë dhe riciklimit të këtij gjimnazi, ndërtimi i një faqeje web, etj.

Qëllimi kryesor është të motivojë të rinjtë që të marrin gjithnjë e më shumë përgjegjësi qytetare duke kontribuar drejtëpërdrejtë në standardin e tyre të jetesës dhe në zhvillimin e jetës komunitare. Po ashtu, Shkolla komunitare nëpërmjet elementit **rekreacion dhe sport**

do të mbështesë çdo inisiativë rinore, e cila i përgjigjet drejtëpërdrejtë këtij komponenti ose edhe tërthorazi njërit prej 4 elementëve të tjerë të parashikuara në këtë projekt. Rezultati final kërkohet të jetë jo vetëm krijimi i një numri sa më të madh aktivitetesh por edhe nxitja e nismave nga vetë nxënësit, pasi shkolla duhet parë si bërthama e shoqërisë ku së bashku me familjen kontribuon në krijimin e qytetarëve të përgjegjshëm, me inisiativë dhe të ndërgjegjshëm për rolin që luajnë ose do të luajnë në të ardhmen në shoqëri.

Nga sa më sipër, kahu i ndërveprimit në trekëndëshin shkollë/mësues – nxënës – prind/komunitet duhet parë jo vetëm si inisiativa që shkolla i “imponon” ndaj nënësve dhe komunitetit por se si komuniteti duhet të përdorë shërbimet e shkollës dhe të “drejtojë” aktivitetet e saj sipas domosdoshmërive imediate që ai ka.

Larmia e veprimtarive të përbashkëta: konkurse apo debate, forume të ndryshme, aktivitete sportive dhe argëtuese, veprimtari solidariteti, etj., dëshirojnë të kontribuojnë në pasurimin e jetës sociale të gjimnazistëve dhe forcimin tek ata të tipareve të tilla të vlefshme si: bashkëpunimi, përgjegjshmëria, toleranca, kreativiteti, etj.

#### **4. Situata sa i përket klubeve të nxënësve.**

Gjatë monitorimit u kontaktua se shkolla nuk kishte klube të nxënësve. U paraqitën disa aktivitete që nxënësit kishin organizuar nën qeverinë e nxënësve dhe ose në lëndë të ndryshme. Klubi i të drejtave të njeriut dhe qytetarisë mund të jetë një klub përveç të tjerëve që ka dhe lidhje me komponentin e vendimmarrjes dhe gjithëpërfshirjes

#### **5. Vlerësim i gjendjes së mjediseve të shkollës**

Referuar supervizioneve të kryera, paraqiten me një sërë mangësish për t’ju përgjigjur objektivave të këtij projekti. Këto mangësi përfaqësojnë dëmtime gjatë përdorimit, realizime difektoze si dhe elemente funksionale që mungojnë.

*Palestra* . Nga vizita e bërë në 14 korrik 2015 u vu re që shkolla e mesme publike A.Z.Cajupi, kishte një palestër të brendshme, e cila për sa i përket sipërfaqjes ishte e mjaftueshme. Palestra e brendshme kishte mungesë të sistemit elektrik për ndriçim. Muret dhe parketi kishin nevojë për shtrim dhe lysterje, mbizotëronte lagështira si në ambientet e palestrës të pa ajrosur dhe me mungesë oksigjeni, ashtu edhe në dhomat e zhveshjeve për nxënësit, në të cilat kishte një mungesë të madhe të kushteve bazë të nevojshme, të tilla si dollapë, dushe, stola, etj. Ishte një ambient i rrezikshëm, i cili dhe për shkak të mungesës së sistemit elektrik përdorej vetëm në ditët me diell dhe mundësisht në orët e para të mëngjesit.

#### **6. Klubet e Nxënësve**

Aktualisht ky gjimnaz ka disa rrethe nxënësish:

1. Rrethin e Letërsisë
2. Rrethin e Biologjisë
3. Rrethin e Ricikluesve
4. Klubin e futbollit
5. Klubin e voleybollit

U vu re që klubi i riciklimit dhe ai i voleybollit dhe futbollit ishin shumë aktivë pasi grupi i riciklimit kishte filluar me riciklimin e shisheve plastike për të ndihmuar në bërjen e karrocave për paraplegjikët, ndërsa me goma automjetesh kishin bërë vazo për lule me të cilat kishin zbukuruar ambjentin hyrës në shkollë.

Klubet e futbollit dhe të voleybollit ishin aktivë duke marrë pjesë në kupat e Pavarësisë nga 2012 e në vazhdim, kishin organizuar një miniolimpiadë duke përfshirë dhe disa fëmijë me aftësi fizike të kufizuara<sup>1</sup>. Nga ana tjetër në konkursin midis gjimnazeve të Tiranës për kupën e minifutbollit, ekipi i “A.Z.Çajupit” fitoi vendin e parë duke mposhtur në finale skuadrën e Ismail Qemalit<sup>2</sup>.

Klubi i Biologjisë përgatit nxënës elitarë pasi nga statistikat e kësaj shkolle vihet re se që prej viteve 2007 e këtej ky gjimnaz është nderuar gjithmone me vende të para në Olimpiadat kombëtare të Biologjisë<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Eshtë theksuar termi “aftesi fizike të kufizuara” pasi ndryshe sipas konventave të reja të KE kjo kategori quhet “fëmijë me aftesi ndryshe” duke përfshirë këtu dhe fëmijet me semundje të ndryshme psikike si sindromi down apo autizmi, por në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me fëmijë parapregjike, tetrapregjike apo shurdhe-memece.

<sup>2</sup> Referohuni për këtë info fotografisë me digituren “Sporti është jete, futu në lojë”

Fitues Olimpiadash Rajonale, Kombëtare Dhe Ndërkombëtare		
Anri Rëmbeci	Vendi III Olimpiada Ndërkombëtare e Fizikës	2004
Bleriti Cela	Vendi I olimpiada Kombëtare e Matematikës	2004
Bledar Isaku	Vendi II Olimpiada Rajonale e Biologjisë, Kimisë	2007
Bleriti Cela	Vendi I I Olimpiada Rajonale e Biologjisë, Kimisë	2007

*Cilat janë klubet që mund të krijohen në shkollë në kuadër të projektit dhe aktivitetet e propozuara?*

Në kuadër të projektit shkolla Komunitare, duke pasur parasysh dhe traditën që ka tashmë ky gjimnaz, propozohet të fuqizohen klubi ekzistues i volejbollit dhe ai i futbollit, duke ju bashkëlidhur dhe bërthamen e **Klubit të Tifozëve të UMB Voley**, nisur dhe nga fakti se komponenti dominues në këtë shkollë do të jetë Rekreativiteti dhe Sporti. Ky **klub i Rekreativitetit dhe sportit** do të përfshijë përvec aktiviteteteve sportive dhe aktivitetet e Këndit të ricikluesve i cili është shumë aktiv në këtë gjimnaz.

Nga ana tjetër duke pasur parasysh se sa kapacitete ka ndër vite kjo shkollë sidomos në shkencat ekzakte, si dhe pasjen e një Smart Classroom do të propozoja dhe organizimin e një **Competitive College Club**.

Duke qenë se prej dy vitesh ky gjimnaz është i përfshirë në Programin Junior Achievement të mbështetur nga MAS dhe AADF do të propozonim dhe ngritjen e klubit **Entrepreneurship and creativity clubs**<sup>4</sup>.

Elsa Baku	Vendi II Olimpiada Rajonale e Biologjisë	2007
Krista Drushku	Vendi I Olimpiada Kombëtare e Kimisë	2008
Juri Anastasi	Vendi I Olimpiada Kombëtare E Matematikës	2008
Ejona Telha	Vendi II Olimpiada Kombëtare E Matematikës	2009
Mistela Qosja	Vendi II Olimpiada Kombëtare e Biologjisë	2011
Ermelinda Avdiaj	Vendi II Olimpiada Rajonale e Biologjisë	2011
Orjeta Sinanaj	Vendi II Olimpiada Rajonale e Biologjisë	2011
Julian Duka	Vendi II Olimpiada Rajonale e Matematikës	2012
Alba Jano	Vendi I Olimpiada Rajonale e Fizikës	2014
Mariza Lleshi	Vendi I Olimpiada Rajonale e Matematikës	2014
Erisa Murati	Vendi I Olimpiada Rajonale e Biologjisë	2014
Ergys Cuka	Vendi III Olimpiada Rajonale e Biologjisë	2014

<sup>4</sup> Marre nga materiali i Historikut të shkolles: "Ne kuader te Memorandumit te Mirekuptimit, mes Ministrise se Arsimit dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan per Zhvillim (AADF), programi Junior Achievement per edukimin e te rinjve shqiptare me njohuri sipermarrese, Shkolla jone eshte integruar prej 2 vitesh ne kurrikulen zyrtare te shkolles sonee si lende me zgjedhje te lire .

Junior Achievement ofrohet si me poshte:

Klasa 11 Njohuri per Biznesin I sipas Junior Achievement, ku jane integruar 2 module Etika e Biznesit dhe Aftesi per Sukses (36 ore vjetore)

Klasa 12 Njohuri per Biznesin II sipas Junior Achievement, ku jane integruar 3 module Shoqerite e Nxenesve, Behu Sipermarres dhe Drejtues per nje dite (34 ore vjetore)"

## 7. Aktivitete dhe Ngritje Kapacitetesh

Kemi menduar duke rënë dakort dhe me stafin e shkollës që mund të organizohen trajnime për mësuesit dhe nxënësit në fushën e IT dhe sporteve. Mund të përdoret Smart Classroom për të dhënë mësimë interkative rreth programeve më të reja kompjuterike, ose metodologjisë së përdorur në lojrat sportive. Për të dy këta komponentë lektorët do të ofrohen nga UMB.

- Trajnim ndërgjegjësues: Trajnim: Promovimi i figurës së arbitrit të futbollit(Tetor – Nëntor)


Edukimi Olimpik në shkollë (takim me nxënësit ku do të flitet nga ana e pedagogëve dhe studentëve të degës së sportit, fillim Maji).

Në rradhë të parë do të ofrohet një mbështetje për të gjitha aktivitetet që shkolla si traditë i kryen çdo vit: si dita e tolerancës, dita e shëndetit, dita e mjedisit dhe tokës, dita e luftës kundër HIV AIDS etj. Këtu një rol konstant do të luajnë edhe klubet studentore të UMB.

- **Konkursi vjetor** që kemi në kuadër projekti
  - **Spartakiadë** mes gjimnazeve ndërdisiplinore
  - **Ndeshja e vitit**(përpara 24 Dhjetorit), në tre disiplina, futboll,basketboll dhe volejball.
  - Ndeshje po në tre disiplina me rastin e **Ditës Ndërkombëtare të Sportit dt.6 prill**
- Në të dy aktivitet e mësipërme ekipet e arbitrave që do të arbitrojnë ndeshjet do të kenë në përbërjen e tyre nxënës nga gjimnazi Çajupi dhe studentë të UMB-së.
-

**Relacion mbi Situatën e Përgjithshme në Shkollën “28  
Nëntori”, Shkodër**

**Dhjetor, 2015**



### **Informacion i përgjithshëm mbi Shkodrën**

Shkodra shtrihet në Shqipërinë veriperëndimore, i themeluar rreth shekujve V-IV p.e.s. Qyteti sot ka rreth 115 000 banorë, është kryeqendra e rrethit dhe qarkut me të njëtin emër.

Qyteti dhe zonat përreth janë të bekuara me një shumëllojshmëri elementesh, si natyrore ashtu edhe kulturore. Lagjet më tërheqëse mendohen të jenë Piacë (është i vetmi qytet në Shqipëri që e quan kështu qendrën e tij), e identifikuar si qendra e qytetit me në qendër statujat e Nanë Terezës dhe Luigj Gurakuqit, dhe Sarreqi Gjuhadoli (lagje e vjetër, emri i së cilës paraqet lodhjen e udhëtarëve që vinin nga Kalaja deri aty) dhe një nga rrugët me skenike,- ku shihen arkitekturat e shumta dhe dora e Kolë Odromenës në disa ndërtesa, që lidh Katedralen nga ana lindore e qytetit me qendrën e qytetit.

Trashëgimia kulturore e Shkodrës për kombin Shqiptar fillon që në shek. XV ku ishte qendër e Humanizmit. Nga ky ambient dolën në dritë humanistë e mendimtarë të shquar, si Marin Barleti e Marin Beçikemi, që me veprat e tyre nxitën në futjen e qytetit në vepra e studime e shkencë të aplikuara. Matematikieni Gjon Gazulli, u konsiderua si një nga astronomët më të shquar të kohës. Dallohet me një nga shkollat më të para në trevat shqiptare më 1698. Historiani E. Jacques shton se edhe të tjera shkolla u hapën “në Pllanë, një fshat afër lumit Mat, më 1638, në Troshan, më 1639”.

Shkodra ka pasur observatorin e parë astronomik në Ballkan. Por të dhënat tregojnë se "akademia" kulturore për të cilën shquhet ky qytet fshihet pas shekujve e shekujve.

Gjatë qindvjeçarëve Shkodra ka qenë një metropol i qytetërimit shqiptar e madje ballkanik.



## 1. Informacion i përgjithshëm mbi shkollën

Gjimnazi publik në Shkodër u hap me një vendim të Këshillit të Ministrave më 11 gusht 1922 ndonëse pa ndonjë ceremoni zyrtare. 37 nxënësit e parë bashkë me katër mësuesit e një nëndrejtor filluan mësimet në shkollën e parë laike të qytetit me pak banka të vjetra, dy tryeza dhe dy dërrasa të zeza në klasa, një tryezë në këshillin pedagogjik e një drejtori ishin fare pak për këtë ngjarje të arsimit në Shkodër dhe më gjërë. Shtypi i kohës shkruante për hapjen e gjimnazit: *"Gjimnazi është problem jetik për shtetin dhe shkodranët duhet të krenohen me të. Gjimnazi i shtetit është me të vërtetë insituti i mesëm që kemi për faqe të bardhë në jetën e re të teknikës arsimore"*. Drejtori i parë i gjimnazit ishte Dr. Xhevat Korça një figurë e njohur e arsimit në atë periudhë. Në këtë vit shkollor u hapën dy klasë një me 32 nxënës dhe dy me 5 nxënës. Gjimnazi kishte tre degë: reale, klasike dhe normale. Në vitin shkollor 1927 – 1928 në degën normale u zhvilluan për herë të parë provimet e maturës dhe në vitin shkollor 1928 – 1929 në degën reale dhe klasike u zhvilluan provimet e matures ku u diplomuan pesë kandidatë, në procesverbalin e mbylljes së vitit shkollor, ndërmjet të tjerave thuhej: *"Për herë të parë bëhet në Shqipni, në gjuhën shqipe provimi i maturës. Të jetë fatlum dhe me fillim të mbarë ky hap me cilin fillon independenca dhe në fushën arsimore të kombit shqiptar"*. Në vitin 1933 u hap dega femërore e gjimnazit me

nëndrejtore zj. Matilde Qarkaxhija, në vitin 1936 kjo degë u shkëput nga gjimnazi dhe doli si shkollë më vete por kjo iu ribashkua gjimnazit të shtetit më 1946.

## **2. Struktura Organizative e Shkollës**

Bordi i shkollës përbëhet nga mësues, kryetari i këshillit të prindërve dhe një përfaqësues nga DAR. Nga informacionet që kemi na rezulton që bordi mbledhet jo shumë shpesh dhe takimet janë kryesisht formale. Sipas drejtoreshë do të ishte më mirë për shkollën nëse bordi do të mbledhej më shpesh dhe do të angazhohej më shumë në veprimtarinë e shkollës. Këshilli i mësuesve ka një përbërje nga secili departament, dhe bëhet një planifikim i lëndëve me zgjedhje që ju propozohen nxënësve dhe më pas nxënësit zgjidhen. Qeveria e nxënësve përbëhet nga 21 anëtarë dhe nga një senator për çdo klasë. Senati i shkollës ka presidentin dhe një sekretare. Nga aktivitetet që realizohen me nxënësit, senati mbledh një sasi të ardhurash prej nxënësve dhe i përdor për aktivitete të tjera. Për qeverinë e nxënësve ka dhe një mësues koordinator që orienton aktivitetet e nxënësve. Këshilli i prindërve përbëhet nga përfaqësues të këshillit të prindërve të klasës dhe merret kryesisht me probleme të procesit mësimor të nxënësve. Në këtë shkollë duhet të ekzistojnë Komisionet e ndryshme si, Komisioni i Etikës dhe Sjelles, Komisioni i Shendetit, Mjedisit dhe Sigurisë së Shkollës, por na rezultoi që funksionojnë Komisioni i Disiplinës, Ekipi kurrikular dhe Komisioni i Maturës

## **3. Dokumentacion i shkollës**

- Shkolla disponon kopje të dokumentave të mëposhtme:
- Rregullorja e shkollës
- Plani afatmesem i shkollës i cili përgatitet nga Bordi i Shkollës
- Plani vjetor lëndor i cili përgatitet nga Drejtorja e shkollës dhe Këshilli i mësuesve
- Plani i aktiviteteve i cili përgatitet çdo fillim viti në bashkëpunim me nxënësit.
- Plani i modulit lëndor
- Plani i modulit profesional

## **4. Objektivat për tu realizuar në shkollën “28 Nëntori”, Shkodër**

Gjatë diskutimit me stafin e shkollës “28 Nëntori”, ramë dakort për krijimin e modeleve të reja të udhëheqjes, qeverisjes dhe gjithëpërfshirjen: Ky objektivi synon realizimin e aktiviteteve dhe ndërhyrjeve që bëjnë të mundur transformimin e modeleve vendimmarrëse të shkollës në modele gjithëpërfshirëse dhe që marrin në konsideratë nevojat e nxënësve dhe komunitetit. Mësuesit, nxënësit, prindërit dhe komuniteti rreth shkollës janë partnerë të rëndësishëm dhe të barabartë në proceset vendimmarrëse që lidhen me organizimin dhe ndikojnë në cilësinë e veprimtarisë së shkollës dhe rrjedhimisht edhe në arritjet e nxënësve. Ata së bashku mund të informojnë, ndikojnë dhe të hartojnë politika, programe e praktika që janë në dobi të veprimtarisë mësimore dhe suksesit të

nxënësve. Shkolla u siguron të gjithë fëmijëve të drejtën themelore për arsim dhe mundësi të barabarta pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive, apo rrethanave ekonomike, respektim të vlerave e shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në një botë gjithnjë e më gjithpërfshirëse dhe të ndërvarur.

*Disa nga çështjet kyçe përfshijnë:*

- Identifikimi i strukturave qeverisëse të shkollës, përfshirë strukturat formale si bordi i shkollës, komiteti i prindërve dhe qeveria e nxënësve dhe struktura të tjera informale (klube nxënësish, organizma të tjera. Si përcaktohet pjesëmarrja në këto struktura, çfarë kriteresh zbatohen? A përfaqësohen të gjitha grupet në strukturat vendimmarrëse (gjinia, statusi ekonomik, etnia, identiteti kulturor, aftësitë, besimi fetar etj.)
- Vlerësimi i procedurave dhe praktikave të marrjes së vendimeve për aktivitetet e shkollës duke filluar nga aktivitetet e zakonshme të shkollës, vendimmarrja për kurrikulat, për planin strategjik të shkollës, planin e aktiviteteve vjetore e më gjerë, zgjedhja e teksteve etj. (Më konkretisht, kush i merr vendimet, a ka një procedurë konkrete? Çfarë roli luajnë fëmijët, prindërit dhe komuniteti në përcaktimin dhe zbatimin e aktiviteteve të shkollës?)
- Identifikimi i ndërhyrjeve në nivel strukturash dhe në nivel procedurash. (A janë të nevojshme struktura të reja për të nxitur vendimmarrjen gjithëpërfshirëse? A duhen ndryshuar disa nga procedurat që ndiqen për marrjen e vendimeve dhe zbatimin e veprimtarive?)
- Identifikimi i mundësive për te gjeneruar fonde alternative përmes formave të vetë organizimit të shkollës me qëllim fuqizimin dhe autonominë financiare për aktivitete që rrisin performancën. (Aktualisht a gjeneron shkolla fonde? Cilat janë burimet? A vlerësojnë shkollat ndonjë mundësi alternative për gjenerimin e fondeve?)
- Është e rëndësishme që të gjitha hallkat e mësipërme të realizohen në bashkëpunim me grupet e interesit, nxënësit, mësuesit, prindërit, aktorë të rëndësishëm të komunitetit.

## **5. Strategjia e stimulimit të gjithpërfshirjes në qeverisje**

*Hapi i parë* do të jetë vlerësimi i strukturave dhe dokumentacionit (rregullore, planet, ekzistuese të shkollës:

- Numri i anëtarëve
- Përbërja gjithëpërfshirëse
- Frekuenca e takimeve
- Përgjegjësitë e secilës strukturë

- Përputhja me përgjegjësitë e strukturave të tjera
- Procedurat dhe rregulloret që ka secili organizëm

*Hapi i dytë* do të jetë vlerësimi i strukturave dhe dokumentave në termat e mjaftueshmërisë, përshtatshmërisë, koherencës, impaktit, aksesit etj. me qëllim ngritjen e një strukture qeverisëse gjithëpërfshirëse dhe të funksionale

## **6. Aktivitetet e propozuara**

Në këtë fazë të parë u diskutua të jetë planifikimi i aktiviteteve vjetore të shkollës në bashkëpunim me grupin e punës për projektin. Kjo do të jetë një mënyrë e mirë edhe për të vlerësuar funksionimin real të strukturave të shkollës.

*Aktivitetet që do të realizohen do të përfshijnë:*

- Aktivitete ndërgjegjësuese për vendimmarrjen gjithëpërfshirëse me grupet e interes (nxënësit, mësuesit, prindërit, organizata të komunitetit).
- Trajnime dhe Workshope dhe aktivitete komunitare.
- Lobim me aktorë në nivel lokal dhe kombëtar për t'i bërë ndryshimet të qëndrueshme dhe afatgjata.
- Aktivitete trajnuese me qëllim rritjen e aftësive dhe kapaciteteve të organeve të shkollës për shkrim dhe zbatim projektsh.

## **7. Situata sa i përket klubeve të nxënësve.**

Në shkollë nuk ekzistojnë klubet e nxënësve, përveçse disa aktiviteteve të organizuara nga nxënësit nën qeverinë e nxënësve dhe ose në lëndë të ndryshme. Klubi i të drejtave të njeriut dhe qytetarisë mund të jetë një klub që ka dhe lidhje me komponentin e vendimmarrjes dhe gjithëpërfshirjes


## **8. Vlerësim i gjendjes së mjediseve të shkollës**

Referuar supervizioneve të kryera, paraqiten me një sërë mangësish për t'ju përgjigjur objektivit të këtij projekti. Këto mangësi përfaqësojnë dëmtime gjatë përdorimit, realizime difektoze si dhe elemente funksionale që mungojnë.

- a. Palestra
- b. Mjediset sportive rrethuese
- c. Biblioteka

**Relacion mbi Situatën e Përgjithshme në Shkollën “Halim  
Xhelo”, Vlorë**

**Dhjetor, 2015**



## Informacion i përgjithshëm mbi qytetin e Vlorës

Vlora është e vendosur në jugperëndim të Shqipërisë përgjatë bregdetit të ulët të Adriatikut dhe Jonit shkëmbor. Me një sipërfaqe prej 1,609 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 200.000 banorë, qarku i Vlorës kufizohet në veri nga Fieri, në lindje nga Tepelena dhe Mallakastra, ndërsa në jug nga Saranda dhe Gjirokastra. Në perëndim Adriatiku dhe Joni shfaqin linja të ndryshme të bregdetit, duke ndërthurrur laguna, gjire, ishuj, gadishuj dhe plazhe të shumta. Vlora është kryeqyteti i parë i Shqipërisë së pavarur. Vlora është e alternuar mes tyre, ku kombinohen të gjitha format e relievit, si fushat e ulëta, kodrinore dhe malore.

Vlora është qendra administrative e qarkut. Ka një gjatësi veri-jug prej 19 km dhe gjerësi lindje-perëndim prej 16 km.

Më 28 Nëntor 1912, në Vlorë, Kuvendi Kombëtar shpall Pavarësinë dhe formoi qeverinë me Ismail Qemal Bej Vlorën në krye.

Vlora është një qendër e rëndësishme tregtare dhe detare në Shqipëri. E zhvilluar është industria e peshkimit, industria e manufakturës tekstile si dhe ajo e ndërtimit. Vitet e fundit ka pasur një zhvillim të madh turizmi, duke u shoqëruar ky zhvillim me ndërtimin e shumë hoteleve, restoranteve, plazheve etj. Vlora prodhon naftë, gaz natyror, bitum dhe kripë.

Vlora është qyteti i dytë me universitetin më të madh në Shqipëri. Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" u krijua në vitin 1994 si një universitet teknologjik. Në fillimet e veta qindra studentë ndiqnin këtë universitet, ndërsa tani rreth ai mbart rreth 15,000 studentë.



## **1. Informacion i përgjithshëm mbi shkollën**

Jemi një grup nxënësish dhe mësuesish të gjimnazit klasik "Halim Xhelo" të Vlorës. Shkolla jonë është një shkollë publike, e cila gjendet 500m nga Sheshi i Flamurit. Ndërtesa e shkollës është e mirëmbajtur edhe pse ka 60 vjet që është ndërtuar. Në nxënësit kemi punuar fortë bashkë me mësuesit dhe prindërit për të pasur një ambient jo vetëm mësimor, por edhe funksional dhe të bukur. Kemi gjithashtu dhe një terren sportiv funksional në pjesën e pasme të ambientit të shkollës dhe një lulishte me lule dhe pemë dekorative përpara. Numri i nxënësve që studiojnë në këtë shkollë është 410, të ndarë në 5 klase të 10-ta paralele, 5 klase të 11-ta, dhe 4 klase të 12-ta. Numri i nxënësve që studiojnë gjuhën italiane është 156, duke qenë se numri i nxënësve që studiojnë italishten është i lartë, shkolla jonë bën pjesë në projektin "Iliria", i cili organizohet nga Konsullata e Përgjithshme Italiane në Vlorë. Përveç procesit të edukimit dhe të mësimdhënies, ne marrim pjesë dhe në aktivitete sociale dhe kulturore. Në mbështetje me Kryqin e Kuq, me Bashkinë e qytetit, me Insitutin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar etj, kemi bërë shumë aktivitete në ndihmë të njerëzve në nevojë të qytetit tonë.

## **2. Vlerësim i gjendjes së ICT në shkollë**

Në shkollën e mesme publike "Halim Xhelo" studiojnë rreth 500 nxënës dhe është e pajisur me 2 laboratorë kompjuterik, me kompjutera të ardhur në vitin 2004, ka 15 P.C me parametra: RAM 256 MB ,HDD 40 GB, nga këta kompjutera vetëm 12 PC janë në funksion. Laboratori tjetër po me rreth 15 P.C, ka kompjutera të ardhur në vitin 2007, Parametrat e tyre variojnë: RAM 512 MB -1GB dhe HDD 80GB. Këta kompjutera janë aktualisht në përdorim për gjithë shkollën, si nga nxënësit për kryerjen e orëve mësimore të lëndës së

Informatikës, ashtu dhe nga stafi pedagogjik i shkollës. Laboratorët mirëmbahen nga vetë nxënësit dhe mësuesja e IT, dhe periodikisht për probleme serioze thërritet një teknik ekspert i jashtëm. Shkolla bashkëpunon me OpenLabs me qëllim ngritjen e kapaciteteve për ndërtimin e faqeve web. Shkolla “Halim Xhelo” ka një website amator ku promovon vetveten, qëllimi është që të ngrihen kapacitetet e përdorimit të shkencave kompjuterike në funksion të programimit të sistemeve të informacionit, e cila do të mundësojë krijimin e përmbajtjeve dhe mirëmbajtjen e një faqeje webi të mirëfilltë për shkollën.

Në kuadër të projektit grupi i implementimit do të krijojë një faqe webi, e cila do të jetë modeli që do të ndjekin të gjitha shkollat si pjesë e SHQK-së, dhe në vazhdimësi do të përditësohet nga vetë shkolla. Pjesë komplementare e angazhimit do të jetë krijimi i një modeli mbi çka mund të virtualizohet në sistemin e shkollave shqiptare dhe implementimi i këtij modeli në një platformë informacioni.

Duke u nisur nga fakti që njohuritë që marrin nxënësit në shkollë mbi konceptet e shkencave kompjuterike, të cilat janë të pamjaftueshme për të arritur nivelet e ICT që kërkohen në shekullin 21, është menduar e arsyeshme të ndërtohet një kurrikulum i ri ICT e cila do të eksplorojë konceptet e shkencave kompjuterike duke prekur edhe temën e programimit. Është gjykuar e nevojshme në bazë të opinionit të vetë mësuesve të shkollës, që të trajnohen këta të fundit për përvetësimin e aftësive në përdorimin instrumenteve të IT gjatë procesit të mësimdhënies. Gjithashtu me qëllim forcimin e bashkëpunimit midis prindërve – shkollës – komunitetit është menduar të organizohen trajnime me këta të fundit me qëllim ngritjen e kapacitetit të përdorimit të instrumenteve të ICT.

### **3. Objektivat e ICT në shkollën “Halim Xhelo”, Vlorë**

Planifikimi i harduerit për laboratorët e IT

Bashkëpunimi me openLabs për ndërtimin e aplikimeve web

Anëtarësimi në Microsoft IT Academic / EIPASS

Shërbimi i regjistrimit elektronik në një nga dy format e mëposhtme:

1. Duke përdorur softet e paketës Office: Excel ose Access
2. Ad hoc – aplikim web ose Visual Studio

Shërbimi i dixhitalizimit të bibliotekës në një nga dy format e mëposhtme:

1. Duke përdorur softet e paketës Office: Excel ose Access
2. Ad hoc – aplikim web ose Visual Studio

Shërbimi i përdorimit të kuptimeve elektronike

1. Duke përdorur open Source: Free QuizMaker ose LCDS (Learning Content Development System)

Shërbime me përmbajtje dinamike si aktivitete interaktive, lojra, animime, demo dhe multimedia të tjera

1. Duke përdorur open Source LCDS

Forma e shërbimit të provimit elektronik

1. Duke përdorur platforma ekzistuese të cilat janë me pagese si classMarker
2. Ad hoc – aplikim web ose Visual Studio

Krijimi i kurseve e-learning

1. Duke përdorur open Source LCDS

Krijimi i rrjetit të komunikimit midis aktorëve nxënës - prind – komunitet - mësues për të nxitur bashkëpunim dhe projekte në grup

1. Përdorimi i platformes open Source Google Apps for Education

Krijimi i E-Portofolio për të mundësuar arkivimin e projekteve të zhvilluara nga nxënësit, aktivitetet e tyre, dhe skedaret e klasave.

1. Duke përdorur tools ekzistues si p.sh Evernote ose Google Sites for Students
2. Ad hoc – aplikim web ose Visual Studio

Përdorimi i formave të ndryshme të multimedias për të krijuar traditë dhe për të ndarë në komunitet aktivitete të ndryshme shkollore si mbrëmjet e maturave, videoklipe eventesh ...

1. Përdorimi i skedarëve të rrjeteve sociale si youtube, flickr ose tumblr
2. Ndërthurja në aplikim web

Trajnime me prindër dhe komunitet për t'i prezantuar dhe t'i mësuar me shërbimet elektronike që do t'i angazhojnë ata në aktivitetet e shkollës komunitare.

Aktivitete që shkolla komunitare do të ofroje për të përfshirë komunitetin e gjerë

Krijimi dhe pilotimi i projekteve bazuar në ICT

Rishikimi i mangesive në kurrikulat ekzistuese për sa u përket tematikave të ICT dhe ngritja e kurikulave të reja të cilat duhet të kulmojnë mangesitë aktuale

#### **4. Ngritja e Klubit të Inovacionit**

Ngritja e Klubit të Inovacionit në shkollën “Halim Xhelo” do të formohet për të përfituar nga moria e mundësive emergjente për risi në arsim, të krijuara nga ndryshimet teknologjike dhe pjesërisht nga globalizimi. Klubi do të funksionojë si një ekip i posaçëm projektsh, duke mbështetur dhe inkubuar ide të reja, dhe menjëherë të krijojë prototipin dhe të zbatojë projekte të mesme-mëdha pse jo dhe strategjike. Misioni i Klubit është që të nxisë risi në lidhje me të gjitha objektivat e shkollës. Klubi do të kërkoj, identifikojë, dhe krijoj mundësi duke zgjedhur më pas ato që janë më premtuese, të cilat në vazhdimësi do të zbatohen duke bashkëpunuar me njësitë operative të shkollës.

Misioni strategjik i Klubit është prekshmëria drejt gjeneratës së ardhshme, nxitja e një lidhjeje të fortë me femijët dhe fillimi i një misioni kritik për të dhënë shtysë të menduarit kritik, aftësive për zgjidhjen e problemeve dhe përdorimin e metodologjive inovative si pjesë e jetesës së tyre.

## 5. Objektivat

- Të identifikojë bazat e kreativitetit dhe inovacionit dhe të ndërlidhen me shërbimet publike të sistemit arsimor.
- Të eksplorojnë ide inovative, metodologji dhe teknologji në grupet e nxënësve në përgjithësi dhe komunitet në veçanti.
- Të organizojë seminare, konferenca, workshop-e, ekspozita në lidhje me inovacionin.
- Të kultivojnë mendime inovative dhe sipërmarrëse
- Të krijojnë mundësi për nxënësit të jenë të angazhuar në aktivitete inovative nëpërmjet workshop-eve kreative dhe teknike.
- Të sigurojnë një platformë për studentët, mësuesit dhe komunitetin të shfaqin aftësitë e tyre duke krijuar risi të reja dhe produkte të rinj.
- Të mbështesë dhe tu vijë në ndihmë inovatorëve të rinj në krijimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë.
- Të dokumentojë rrisitë duke i diferencuar si rrugëtime reale.
- Të ndërlidhë inovatorët e rinj dhe produktet e tyre me rrjetin e tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo do t'ju japi atyre më shumë qëllim dhe identitet.

## 6. Aktivitetet

Misioni Klubit të Inovacionit është të krijojë vetëdije, edukojë, inkubojë, ngulit kulturën e inovacionit midis fëmijëve dhe ti aftësojë ata që të gjenerojnë ide të reja dhe të jenë më inovativ. Ekzekutimi i një programi i cili do të konsistoj në një sërë aktivitete projektimi dhe zhvillimi të cilat do të drejtohen duke përdorur materiale të ofruara nga qendra shkencore. Qëlimi është që të kultivohen aftësitë e kreativitetit dhe të *'problem solving'* midis nxënësve dhe të drejtohen ata të ndërmarrin metodologji e të menduarit out-of-the-box në dhënien e zgjidhjeve ose përmirësimin e mënyrës sesi ata do ta analizojnë dhe zgjidhin një problem në aktivitete të tyre ditore si:

- Formimi i një komiteti këshillues lokal i cili përfshin anëtar nga segmente të ndryshme të komunitetit dhe një grup mentorësh për të drejtuar aktivitetet
- Regjistrimi i nxënësve si "Pjesëmarrës të Klubit të Inovacionit" dhe mundësia për të punuar në projekte inovative ose pjesëmarrja në aktivitete pas shkollës, fundjavë apo gjatë pushimeve verore.
- Ekspozim/Seksione të grupit për 2-3 orë/javë.
- Do të organizohen aktivitete/panaire dhe konkurse me qëllim që të kultivohet dhe mbahet gjallë shkëndija e krijimtarisë, rrisë dhe projektimit.
- Bashkëveprim periodik i Klubit me Inovator/Shpikës dhe Kërkues.
- Workshope periodike mbi *'problem solving'*, gjenerimi i ideve dhe zgjidhjeve të reja.
- Shfaqje periodike filmash mbi temat e shpikjeve dhe inovatorëve.
- Inkurajohet Klubi të përdori burimet e vlefshme lokale për aktivitete praktike me qëllim që të komplementoj kurikulumin mësimdhënës në shkollën e tyre.
- Drejtim për zhvillimin e zgjidhjeve shkencore inovative për të zgjidhur probleme të realitetit të përditshëm.

## **7. Përgjegjësitë e shkollës**

- Të vendoset në dispozicion një ambient prej afërsisht 100 m<sup>2</sup> ku do të instalohet Klubi.
- Të përcaktohen dy mësues nga shkolla si përgjegjës për funksionimin dhe facilitetet e Klubit të Inovacionit.
- Të zgjidhet një grup prej 20-50 nxënësish të cilët do të punojnë në Klub nën mbikqyrjen e mësuesve të zgjedhur në pikën e mësipërme.
- Të ngrihet një komitet monitorimi për Klubin i përbër nga 1 mësues Lider, 1 mësues mbështetës dhe 1 student lider.
- Facilitetet e Klubit të jenë të aksesueshme edhe nga nxënës dhe mësues të shkollave dhe komunitetit lokal të rajoneve/qyteteve fqinje.
- Të krijohen lidhje me organizata, institute dhe OJQ për aktivitetet e ndryshme të Klubit.
- Të dërgohen raportime periodike (psh çdo 3 muaj) tek drejtuesit e projektit të cilat përcjellin suksesin apo rezultatin e aktiviteteve.
- Të kordinoj me drejtuesit e projektit takime periodike për kontroll/inspektim të Klubit.
- Të marri dhe garantoj të gjitha masat e sigurisë për mirëmbajtjen e Klubit.
- Të siguroj që facilitetet e Klubit të jenë në përdorim vetëm të objektivave të parashikuara.
- Të organizoj konkurse ku të jepen çmime.

## **8. Përgjegjësitë e drejtuesve të projektit**


- Të pajiset ambienti i Klubit me tavolina pune, karrige, stola etj.
- Të sigurojë mbështetjen teknike në formën e aparaturave, pajisjeve, materialeve, manualeve të projektit etj.
- Të sigurojë postera, grafik, manuale përdorimi, broshura dhe publikime të tjera të cilat do të krijojnë kit-e, materiale mësimdhënieje, dhe do të shërbejnë për organizuar programe të orientuara drej komunitetit.
- Të sigurojë facilitete shtesë për Klubin si dhe kur të jetë e nevojshme.
- Të sigurojë ekspozita, filma, ekspert *R&D (Research & Development)* për të organizuar programet e Klubit.
- Të sigurojë trajnimet e nevojshme për personelin e angazhuar në drejtimin e Klubit.
- Të monitorojë aktivitetet e Klubit.
- Të inkurajojë diskutim dhe bashkëveprim midis studentëve, mentorëve, dhe inovatorëve.
- Të organizojë grante periodike për Klubin me qëllim që të mbështesë programet dhe ekzekutimin e aktiviteteve rutinë.

## **9. Vlerësim i gjendjes së mjediseve të shkollës**

Referuar supervizioneve të kryera në shkollën “Halim Xhelo” u paraqitën një sërë mangësish për t’ju përgjigjur objektivit të këtij projekti. Këto mangësi përfaqësojnë dëmtime gjatë përdorimit, realizime difektoze si dhe elementeve funksionale që mungojnë: a. Palestra b. Mjediset sportive rrethuese c. Biblioteka

**Relacion mbi Situatën e Përgjithshme në Shkollën “Raqi  
Qirinxhi”, Korçë**

**Dhjetor, 2015**



### **Informacion i përgjithshëm mbi Korçën**

Korça ndodhet në Shqipërinë jug-lindore.

Ekonomia e qytetit të Korçës i ka themelet e saj në zhvillimin bujqësor, por nuk mund të lihen pa përmendur bizneset e mëdha të qytetit të cilat përfshijnë kryesisht sektorin e ndërtimit civil dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit, sektorin ushqimor dhe atë të shërbimeve. Edhe pse Korça ofron mundësi të mira për zhvillimin e turizmit, ngelet akoma shumë për të bërë në këtë drejtim. Niveli ekonomik i qytetit aktualisht ndodhet në një rritje kostante edhe pse duhet të sigurohet akoma stabiliteti ekonomik sipas standardeve të BE - së.

Turizmi në këtë qytet ka dy pika të rëndësishme e të frekuentuara shpesh nga turistët, fshatrat Voskopoja e Dardha. Përveç klimës malore, me pyje të dendur me pisha e bredha, dhe prezencën e një peisazhi mbreslënës, turistët mund të gjejnë pjesë nga historia dhe trashëgimia e popullit shqiptar duke filluar nga periudha e sundimit Bizantin.

Qyteti i Korçës lidhet dhe me shkollën e parë të gjuhë shqipe. Mësonjëtorja e Korçës u hap më 7 mars të vitit 1887, në shtëpinë e ofruar për mësimdhënie nga Diamanti Terpo. Kjo ndërtesë është shndërruar sot në museum kombëtar të arsimit. Mësuesi dhe drejtori i parë i kësaj shkolle e filloi mësimin në gjuhë shqipe dhe me 35 nxënës. Hapja e kësaj shkolle për nga karakteri kishte tipare demokratike, pasi në të mësonin fëmijët e të gjitha shtresave, të varfër e të pasur. Hapja e shkollës ishte një ngjarje dhe një fitore e madhe për gjithë lëvizjen

kombëtare. Mësonjëtorja e Korçës ishte qendër e rëndësishme për formimin kulturor dhe ngritjen e ndërgjegjes dhe moralit në popull. Ajo nxiti edukimin patriotik të brezit të ri e të masave të gjera. Shkolla tërhoqi interesin dhe admirimin e shumë shqiptarëve, nën shembullin e saj u frymëzuan më vonë edhe banorë të viseve dhe trevave të tjera shqiptare.

Veç të tjerash kjo ngjarje ishte një fitore e madhe për popullin shqiptar, pasi deri atëherë dhënia e mësimave për shkak të pushtimit osman bëhej privatisht brenda shtëpive në mënyrë të fshehtë. Kështu, që nga ajo ditë, 7 marsi festohet në Shqipëri si dita e mësuesit për të përkujtuar atë ngjarje të rëndësishme kulturore dhe historike.



### **1. Informacion i përgjithshëm mbi shkollën**

Gjimnazi publik “Raqi Qirinxhi”, Korçë është hapur në vitin 1917 dhe tashmë ka krijuar fizionominë e tij si një nga shkollat më të suksesshme jo vetëm në rrethin e Korçës, por dhe më gjerë, për arritjet e sotme dhe si vazhdim i Liceut Francez me vlerat e një historie kombëtare. Shkolla mban emrin e Dëshmorit të Atdheut dhe Mësuesit të Popullit Raqi Qirinxhi, që nga viti 1945 dhe ndodhet në rrugën “Pano Xhamballo” të qytetit të Korçës. Shkolla ka marrë vlerësime në vite si, “Hero i punës”, “Pishtar i Demokracisë”, çmimin “Për rezultate të shkëlqyera në Maturën Shtetërore” në vitin 2006 apo “Shkolla më e mirë në rreth” në vitin 2008. Ky gjimnaz ka dimensionet e një gjimnazi bashkëkohor në formë e në përmbajtje, si dhe ka vizione të qarta për të ardhmen, për sfidat që e presin, për misionin, besimin si elemente të rëndësishëm të kësaj shkolle.

Shkolla vazhdon të ruajë traditën e Liceut Francez, duke zhvilluar me sukses mësimdhënien e mësimnxënien në seksionin dygjuhësh shqip-frëngjisht, përmes bashkëpunimit të suksesshëm me Ambasadën Franceze në Shqipëri dhe Aleancën Franceze.

## **2. Struktura Organizative e Shkollës**

Shkolla “Raqi Qirinxhi” është ndërtuar në vitin 1970 dhe u rikonstruktua në vitin 2011. Ka një sipërfaqe prej 2.4 ha përfshirë dhe terrenin sportiv. Shkolla ka 22 klasa mësimore, 18 klasa me mesatarisht 36-37 nxënës për klasë. Në vitin shkollor 2015-2016 shkolla ka 18 klasa, 6 klasa të X-ta, 6 klasa të XI-ta dhe 6 klasa XII-ta. Gjithsej shkolla ka të regjistruar për këtë vit shkollor 621 nxënës, 369 femra dhe 252 meshkuj. Në gjimnazin “Raqi Qirinxhi” japin mësim 38 mësues nga të cilët 25 femra e 13 meshkuj. Të gjithë mësuesit zhvillojnë mësim në përputhje me diplomat e tyre. Në shkollë funksionon biblioteka me një fond librash prej 8500, e cila është e dixhitalizuar dhe punohet vazhdimisht për pasurimin e saj. Një laborator fizike që mbulon 100% programin e kësaj lënde, një laborator TIK ku funksionojnë vetëm 14 kompjutera (pra një kompjuter për 47 nxënës ose çdo orë TIK një kompjuter për rreth 3 nxënës), një laborator kimie që mbulon jo më shumë se 15% të programit në kushte jo të mira, një kabinet biologjie, dy mjedise me tabela elektronike, një palestër, sallë force e me mjediset përkatëse (por pa bazën e nevojshme materiale), një sallë provimesh dhe takimesh jo shumë e përshtatshme si dhe muzeun e shkollës, por në të gjitha këto ambiente mungon sistemi i ngrohjes, si dhe mjetet e domosdoshme didaktike.

## **3. Objektivat e për tu realizuar në shkollën “Raqi Qirinxhi”, Korçë**

Vendosëm bashkë me stafin e shkollës “Raqi Qirinxhi” për realizimin e komponentit Mësimdhënia dhe Nxënësi Aktiv, i cili ka si synim të motivojë gjithëpërfshirjen e komunitetit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë. Po ashtu synohet të ofrohet mbështetje për nxënësit dhe prindërit e tyre në zgjedhjen ecurime të kurrikulave të zbatuara dhe atyre me zgjedhje për një proces të të nxënësve sa me efikas. Nga ana tjetër, realizimi i këtij komponenti synon të nxisë gjithëpërfshirjen e nxënësve në zgjidhjen e problemeve të komunitetit nëpërmjet aplikimit të metodologjive ndërvepruese për mësimdhënien dhe të nxënësve, përdorimin e aftësive sociale për të punuar në ekip, të aftësive të të menduarit krijues dhe kritik.

### **4. Aktivitetet kryesore:**

- Rishikimi i kurrikulave, programeve, materialeve didaktike dhe procesit mësimor që aktualisht zbatohet në shkollë
- Përcaktimi i një modeli të ri të edukimit dhe mësimdhënies në përputhje me parimet e një zhvillimi të qëndrueshëm si dhe për promovimin e përfshirjes së nxënësve në

aktivitete kulturore dhe krijuese vendore lokale, duke krijuar faqen e internetit të shkollës.

- Zhvillim kapacitetesh: zhvillimin e kompetencave të reja për mësuesit në përcaktimin dhe menaxhimin e kurrikulës me zgjedhje në mënyrë që të kontribuojnë në nevojat lokale të zhvillimit, të përdorimit të metoda dhe teknikave të edukimit interaktiv, ngritje kapacitetesh dhe kompetencash të mësuesve dhe nxënësve për të zhvilluar punime krijuese, veprimtari kulturore dhe materiale didaktike të riciklueshme dhe të qëndrueshme, të krijojë kompetencat e nevojshme tek prindërit dhe përfaqësuesit e komunitetit për përcaktimin e kurrikulave me zgjedhje si dhe për mbështetjen e nxënësve për të bërë përzgjedhjen më të mirë për mësimnxënjen e tyre.
- Zhvillimi i kurrikulave me qendër komunitetin: Përcaktimi i një pakete të re kurrikule me zgjedhje e cila përputhet me nevojat lokale, zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore për krijimin e aftësive të rinjve që përputhen me nevojat lokale, pasurimin e bibliotekave me tekste të reja jashtëshkollore, zhvillimin e një moduli për zhvillimin profesional të mësuesit në aplikimin e të mësuarit interaktiv

*Si paraqitet gjendja duke iu referuar kurrikulave :* Kurrikula me zgjedhje të lirë, është klasike (Matematikë, Fizikë dhe Letërsi e thelluar). Orët e Shërbimit vullnetar janë kryer. Ka module profesionale por nuk zgjidhen nga nxënësit, këtu në bashkëpunim me këshillin e prindërve mund të nxiten dhe promovohen këto module, ndoshta edhe të ri-formatuara. Ka eksperiencën të zhvillimit të lëndëve profesionale në ambiente (ndërmarrje/oficina) ku ekziston mundësia e praktikave

(Mbetet për tu analizuar: Një informacion për projektin kurrikular të shkollës dhe projektin lëndor

Si dhe identifikimi i gjendjes së mjeteve mësimore didaktike)

*Si do të përvijohet modeli i ri i të nxënësve sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm duke iu përgjigjur nevojave lokale?*

Shkolla ka një traditë në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme si: qeveria e nxënësve të shkollës ka organizuar aktivitete në drejtim të mbajtjes pastër dhe gjelbërimit të mjedisit, marshime të ndryshme si dhe mjaft aktivitete argëtuese; organizimi i muajit të frankofonisë, panairi i librit, olimpiadat në lëndë të ndryshme, konkurset e ndryshme midis klasave brenda shkollës

Shkolla gjithashtu ka një traditë në bashkëpunime me komunitetin dhe aktorë të tjerë vendorë:

- Bashkëpunim me **Aleancën franceze** të Korçës, Tetor 2014, aktiviteti mbi rolin e Francës në luftën e parë botërore.
- Bashkëpunim me **bashkinë e qytetit** në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike e sportive si: karnavalet e Korçës, konkursi me fotografi e piktura në lidhje me traditën

korçare, gara të ndryshme sportive si garat me biçikleta, vrapimet e distancave të ndryshme, kampionati i mini-futbollit, i skive, i volejbollit dhe basketbollit në kuadër të shkollave të mesme të qytetit

- Bashkëpunim me institucione të ndryshme në qytet si ***shtëpia e foshnjës, qendra e personave me aftësi të kufizuara, kryqi i kuq shqiptar*** ku janë zhvilluar aktivitete të cilat synojnë ndihmën ndaj personave me nevoja të veçanta.
- Bashkëpunim me ***komunitetin***, qeveria e nxënësve të shkollës ka organizuar aktivitete në drejtim të mbajtjes pastër të mjedisit puna e përbashkët e shkollës me bordin e shkollës, këshillin e prindërve, shërbimin psikologjik në shkollë është përqendruar kryesisht ***në drejtim të nxënësve problematike në shkollë***, ky mund të jetë një hap i parë për të intensifikuar bashkëpunimin në aktivitete të tjera në ndihmë të komunitetit.

Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve dhe kompetencave konstaktuam një nevojë sensibilizimi sidomos të këshillit të prindërve për të mbështetur dhe inkurajuar nxënësit drejt zgjedhjeve më të mirë të kurrikulave që kontribuojnë për nevojat lokale të zhvillimit, pasi zgjedhja e nxënësve është rezultat i këshillimit të prindërve. Gjithashtu, nevojitet stimulim i mësuesve në zhvillimin e aktiviteteve ekstra-kurrikulare me njohje si orë-pune jo vullnetare

## **5. Propozimet për paketa të reja kurrikulare që përputhen me nevojat lokale**

Duke u nisur nga fakti që kurrikula me zgjedhje të lirë, është klasike (Matematikë, Fizikë dhe Letërsi e thelluar) si dhe nevojave të qytetit, kjo krijon hapësira për propozime të kurrikulave të reja të cilat mund ti vijnë në ndihmë komunitetit dhe ku shkolla/qyteti ka një traditë, si p.sh.:

- Gjuha Franceze e thelluar (bashkëpunim me Aleancën Franceze në Tiranë), në mënyrë që të rritet niveli i certifikimit të nxënësve në gjuhën franceze duke arritur deri në nivelin B2 sipas kornizës evropiane të gjuhëve të huaja.
- Trashëgimi dhe Guida turistike (Korça është një destinacion turistik, dhe ka nevojë për ‘ciceronë’ të cilët të mund të ofrojnë guida në gjuhë të huaja; këtu mund të ndiqet shembulli i gjimnazit tjetër ‘Themistokli Gërmenji’ i cili ka një kurrikul të tillë në gjuhën Italiane, Shkolla Raqi Qirinxhi mund të jetë Komplementare në gjuhë të tjera (Gjuha Franceze, Gjermane, Angleze)

Shkolla nuk ka Klube Nxënësish, por disa organizime sporadike në mënyrë vullnetare të organizuara nga mësuesit. P.sh. ‘grupi i retorikës’ i drejtuar nga mësuesi i letërsisë. Biblioteka e shkollës ishte në gjendje të mirë dhe me një fonotekë disi të pasur, gjykojmë se ka nevojë për përditësim dhe fond librash aktualë. Dixhitalizimi i këtij fondi është një iniciativë të cilën shkolla e ka nisur pasi ka edhe aparaturën përkatëse


Përsa i përket prezencës së laboratorëve ICT në shkollën “Raqi Qirinxhi”, kontaktuam se, ka dy laborantë ICT me aparaturat për mësimdhënie inter-aktive, se mungon faqja zyrtare e shkollës dhe ka vetëm një faqe facebook-u, e cila përditësohet në mënyrë jo të rregullt.

Referuar supervizioneve të kryera, në lidhje me mjediset e shkollës u paraqitën me një sërë mangësish për t'ju përgjigjur objektivit të këtij projekti. Keto mangësi përfaqësojnë dëmtime gjatë përdorimit, realizime difektoze si dhe elemente funksionale që mungojnë.

- b. Palestra dhe sallat e tjera të sportit kanë nevojë për ristrukturim dhe mirëmbajtje të mureve
- c. Mjediset sportive rrethuese dhe fusha e sportit është në gjendje rikonstruksioni, kërkohet përfundimi i projektit. Në shkollë ka kosha riciklimi
- d. Biblioteka është në gjendje relativisht të mirë, si rezultat i punës vullnetare të nxënësve, gjithsesi mund të investohet në raftet, tavolina dhe karrige të reja dhe hedhja online e fondit të librave e cila mund të jetë e disponueshme edhe për komunitetin, sistemi i ngrohjes për bibliotekën mungon.

**Relacion mbi Situatën e Përgjithshme në Shkollën “Said  
Najdeni”, Peshkopi**

**Dhjetor, 2015**



### **Informacion i përgjithshëm mbi Peshkopinë**

Peshkopia shtrihet në verilindje të Shqipërisë. Pozita e këtij rrethi ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj zone që ka qenë herë pozitiv e herë negativ gjatë periudhave të ndryshme historike dhe nën ndikimin e faktorëve socialë dhe ekonomikë që kanë lënë gjurmë. Rolin e saj pozitiv ajo e ka patur kur ka shërbyer si një urë lidhëse për trevat e vendit tonë nga perëndimi në brendësi të territoreve shqiptare. Që në antikitet ka funksionuar rruga Durrës-Fusha E Tiranës–Dibër e cila lidhte bregdetin me vise të tjera lindore. Rolin e kësaj pozite e dëshmon qartë zhvillimi social-ekonomik, pasi në 1911 Dibra ishte një qendër e rëndësishme artizanale, tregtare, ndërtimore etj; për këtë flasin qartë të dhënat e popullsisë kur ky rreth kishte 11.000 banorë. Por roli i kësaj pozite zbehet me vendosjen e kufijve arbitrarë në 1913 ku jashtë mbetën qendra të mëdha tregtare dhe urbane për kohën si (Dibra e Madhe). Pas 1913 kjo zonë vazhdoi ta luante këtë rol por me një intensitet më të dobët. Deri kur në vitet 1945-1990 u ndërpre plotësisht kjo lidhje dhe u kthye në një faktor pengues dhe izolues për të. Pas viteve 1990 kjo zonë e rimerr rolin e saj lidhës, por me një intensitet më të vogël por që gjithsesi vlen për tu përmendur si projekti i ndërtimit të autostradës që do të kalojë nëpër rrugën e vjetër dhe lidhja e saj me një arterie me rrethin e Kukësit do të rikthente rëndësinë e pozitës gjeografikë këtij rrethi së bashku me burimet që përmban dhe do ta kthente këtë rreth në një qendër të një eurorajoni ndër-kufitar, dukurë që pozita të bëhet faktor zhvillimi.

Piktura është një domethënie e rëndësishme e artit në Peshkopi. Gjithashtu kënga muzika dhe literatura kanë ekzistuar që në kohë të hershme. Këngën dhe muzikën e mbështet ndër vite një qendër kulturore e rëndësishme për fëmijët e quajtur "Qendra Kulturore e Fëmijëve".



## **9. Informacion i përgjithshëm mbi shkollën**

Gjimnazi "Said Najdeni", Peshkopi është hapur për herë të parë në vitin 1962 me vendim të Këshillit të Ministrave. Fillimisht ky gjimnaz ka ekzistuar në ambientet e shkollës 7-vjeçare "Demir Gashi", më vonë ky gjimnaz kaloi në ambientet e shkollës pedagogjike dhe së fundmi në ambientet e sotme.

## **10. Struktura Organizative e Shkollës**

Gjimnazi "Said Najdeni" ka 47 mësues, një sekretare, 5 sanitare dhe 3 punonjës sigurie.

## **11. Objektivat për tu realizuar në shkollën "Said Najdeni", Peshkopi**

Komponenti që duhet thelluar në gjimnazin "Said Najdeni", Peshkopi është nxënia aktive në komunitet. Ky komponent ka si qëllim të krijojë praktika të reja të të nxënësve, duke i zhvilluar ato nëpërmjet një ndërveprimi të vijueshëm midis të nxënësve në klasë dhe problemeve reale ekonomike dhe sociale të kontekstit. Ndërhyrjet e parashikuara synojnë të krijojnë një dialog të vazhdueshëm mes nxënësve dhe komunitetet lokal ne zgjidhjen e problemeve të ndryshme me anë të organizimit të iniciativave dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare. Mbështetur në dokumentet zyrtare që lidhen me kurrikulën dhe zbatimin e ligjshmërisë, gjimnazi mund të përgatisë apo të zhvillojë materiale që lidhen me "Të nxënësve aktiv në komunitet" nëpërmjet: Projekteve kurrikulare lëndore në nivel klase, Projekteve kurrikulare në nivel shkolle, Moduleve profesionale, Shërbimit vullnetar, Përfshirjes së përdorimit të TIK në të gjithë kurrikulën e gjimnazit si në atë bërthamë, por dhe atë me zgjedhje , Veprimtarive jashtëkurrikulare. Projekti do të mbështesë një zhvillim cilësor të drejtimeve të mësipërme

*Çfarë risish ofron projekti për këtë qëllim?* Ekipi zbatues i projektit në bashkëpunim me drejtorinë e gjimnazit dhe stafin e mësuesve do të identifikojë në shkollë praktikën që zbatohen për të motivuar të nxënësit aktiv në komunitet.

*Projekti do të mundësojë:*

- identifikimin e nevojave dhe interesave të komunitetit për t'u zhvilluar
- zhvillimin e veprimtarive me nxënës-mësues-prindër me tematikë të posaçme që lidhen gjendjen ekonomike dhe sociale të komunitetit përreth shkollës, të cilat do të trajtohen në orët mësimore të lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje, ku do të marrin pjesë dhe prindër
- zhvillimin e moduleve profesionale duke i lidhur ato me trashëgiminë artizanale, kulturore, bujqësore dhe blegtorale të zonës, etj
- zhvillimin e projekteve kurrikulare në klasë dhe në shkollë duke përfshirë prindër dhe nxënës në hartimin dhe zbatimin e tyre, si dhe duke zgjedhur tema mësimore që lidhen shumë me interesat e komunitetit që edukojnë dhe përgjithësojnë praktika të mira të zhvillimit të jetës komunitare
- zhvillimin e veprimtarive jashtëkurrikulare me përfshirjen aktive të nxënësve dhe komunitetit që kanë të bëjnë me aktivitetet kulturore, sportive, festa lokale dhe kombëtare, si dhe në promovimin e vlerave dhe traditave më të mira të komunitetit në turizëm, kulinari, në çështje të shëndetit dhe të mjedisve që ofron komunitetit dibran për këtë çështje.
- Zhvillimin cilësor të veprimtarive të edukimit dhe të të nxënësve nëpërmjet përdorimit të TIK, duke mundësuar zhvillimin e programeve të përshtatshme dhe interesante të TIK për të rinjtë, por për prindër të interesuar, që do të lehtësojnë këtë bashkëpunim të ndërsjellë.

### **3. Vlerësim i gjendjes së mjedisve të shkolles**

Referuar supervizioneve të kryera, paraqiten me një sërë mangësish për t'ju përgjigjur objektivit të këtij projekti. Këto mangësi përfaqësojnë dëmtime gjatë përdorimit, realizime defekte si dhe elemente funksionale që mungojnë.

- e. Palestra
- f. Mjediset sportive rrethuese
- g. Biblioteka

## **12. Dokumentacion i shkollës**

Gjatë vizitës në gjimnazin "Said Najdeni" na u dhanë dorazi dokumenti i Ekipit Kordinues të Shkollës si Qendër Komunitare dhe dokumenti i Planit mësimor për vitin 2015-2016, të cilët i gjeni bashkalidhur këtij raporti.

### **13. Aktivitetet e propozuara në Gjimnazin “Said Najdeni”, Peshkopi**

- Promovimi i programit Matrix si një ndihmesë e mësimit plotësues dhe dixhital. Komunikimi mësues- nxënës në internet nëpërmjet programit Matriks.
- Jeta pa internet. Secili nxënës lexon një libër jashtëshkollor dhe ndan përshtypjet me nxënësit e tjerë. Si interneti ka zëvendësuar negativisht librin.
- Panairi i ushqimit, gatime tradicionale të rrethit Dibër. Krahas kulturës së gatimit shpaloset dhe historiku i zonave të Dibres përmes gastronomisë. Me të ardhurat e mbledhura nga shitja e gatimeve të përgatitura nga nxënësit, dhurohen shporta ushqimesh për familjet në nevojë.
- Integrimi European, pasurimi i njohurive rreth institucioneve bazë të BE-së, postera, foto, informacione, fletëpalosje.